



## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 të datës 27.12.2006, dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2015, miratoi,

### **VENDIM**

### **PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE**

#### **Neni 1**

Miratohet kërkesa e z. Muharrem Isufit nga fshati Majac, për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 2044-2 kultura – arë kl. 3 vendi i quajtur Ara nën rrugë në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup> Zona kadastrale Majac, certifikata nr. 08-095/6915 të datës 22.01.2015.

#### **Neni 2**

Investitori obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë për ndërtimin e objektit shtallë.

#### **Neni 3**

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### **Neni 4**

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 5**

Vendimin e zbatojnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 6**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-350-16505**  
**Podujevë,**  
**4 shkurt 2015**



**Kryesues i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**